
DEVELOPMENT OF SMALL BUSINESSES IN KOSOVO

Shyqeri Kabashi
biznesi@gmail.com
Fatos Sadiku
Fatos10@live.com
Abetare Kabashi
abetare@live.com

Abstract: This paper elaborates on: who are the small businesses, how is the idea for their establishment and when should they be established, in what areas and what are the procedures of establishment. Then, to continue when small businesses in Kosovo are being established, how big is their total number, which region has more businesses, what are the more activities, what is the total number of employees and at; according to regions, areas of activity and gender.

What are the objectives of the work?

The main objectives of the work were:

- What is the total number of small businesses in the Republic of Kosovo
- What is the total number of small businesses according to the field of activity in the Republic of Kosovo
- What is the total number of small businesses per region in the Republic of Kosovo
- What is the total number of small businesses according to the number of employees in the Republic of Kosovo?

To realize this goal we used the method of analysis, synthesis, comparison, etc.

Keywords: small businesses, economic development, scope, etc.

ZHVILLIMI I BIZNESEVE TË VOGLA NË KOSOVË

Shyqeri Kabashi
biznesi@gmail.com
Fatos Sadiku
Fatos10@live.com
Abetare Kabashi
abetare@live.com

Abstrakt: Në këtë punim shtjellohet :kush janë bizneset e vogla, si lind ideja për themelimin e tyre dhe kur duhet të themelohen në cilat fusha dhe cilat janë procedurat e themelimit. Pastaj për të vazhduar kur kanë filluar të themelohen bizneset e vogla në Kosovë, sa është numri i tyre i përgjithshëm, cili regjion ka më shumë biznese, në cilat veprimtari ka më shumë, cili është numri i përgjithshëm i punëtorëve dhe at; sipas regjioneve, fushave të veprimtarisë dhe gjinisë.

Cilat janë objektivat e punimit?

Objektivat kryesore të punimit kishin me qenë:

- Sa është numri i përgjithshëm i bizneseve të vogla në Republikën e Kosovës
- Sa është numri i përgjithshëm i bizneseve të vogla sipas fushës së veprimtarisë në Republikën e Kosovës
- Sa është numri i përgjithshëm i bizneseve të vogla sipas regjioneve në Republikën e Kosovës
- Sa është numri i përgjithshëm i bizneseve të vogla sipas numrit të punëtorëve në Republikën e Kosovës për realizimin e kiti qëllimi kemi përdorur metodën e analizës, sintezës, krahasimit,etj

Fjalët kyçe: biznese të vogla, zhvillim ekonomik, fushëveprimtari,etj

HYRJE

Bota bashkohore, sot si kurr më parë, po zhvillohet në saje të zhvillimit përkatësisht rritjes së bizneseve të vogla. Bizneset e vogla, sot në zhvillimin e ekonomisë marrin pjesë mbi 65%. Ky zhvillim i hovshëm nuk mund të imagjinohet pa pjesëmarrjen e bizneseve të vogla. Pra, bizneset e vogla janë katalizator të zhvillimit të ekonomive. Shiqar historikisht bizneset e vogla në Kosovë kanë filluar të zhvillohen që nga viti 1990, dhe atë duke u rritur si numër më të madhë pas vitit 1992, kur masovikisht largohen punëtorët shqiptar nga vendet e punës, të cilët ishin të punësuar neper ndermarrje shoqërore në Kosovë, nga pushtuesi serb. Në këtë punim jemi munduar të paraqesim se cilat janë format e e kyçjes në biznes, para cilave dilema gjindet apo gjinden themeluesit, cilat janë arsyet e themelimit të biznesit, sa është numri i bizneseve të vogla që nga pas lufta (1999) e deri më 31.12.2016, në cilat veprimtari janë regjistruar më shumë biznese dhe pse, sa ka qenë rritja e numrit të

bizneseve per çdo vit,si ka ndikuar ndihma e shtetit dhe a ka pas ndihme nga shteti,etj.Keto dhe karakteristikat tjera do i paraqesim si me posht.

SI TË THEMELOHET NJË BIZNES?

- Përsoni apo përsonat, para se të marrin vendim për ta themeluar një biznes ballafaqohen me një numër të dilemave elementare, të cilave duhet dhënë përgjigje, dhe atë: ¹⁵²

1. kur të iniciohet themelimi i biznesit,
2. kur të themelohet biznesi,
3. cili do të ishte sektori etj.

Këto kishin me qen vetëm disa nga dilemat (pyetjet) më kryesore me të cilat ndeshet apo ballafaqohen përsoni apo përsonat para se të filloj me themelimin e biznesit. Pasi që përsoni të ia qartësoj veltës se:kur të inicohet themelimi,kur të themelohet biznesi si dhe në cilin sektor ta hap biznesin-fillon procedurën për themelimin e biznesit. Për procedurat, formen, menyrën, formularet, aplikimin, dokumentat e nevojshem,etj dhe procedurat e mëtutjeshme, individit apo individet inform atat i marrin nga zyrat për regjistrimin e bizneseve nëpër regjione apo komuna.

Përsoni (individit) apo përsonat që deshirojn ta bëjn rexhistrimin e biznesit paraprakisht kan dy mundësi të kyqjes në biznes,dhe atë: ¹⁵³

1. Themelimi i një biznesi të ri
2. Kyqja në biznesin ekzistues.

Lidhur me këtë literatura dhe praktika njih përparësit dhe të metat e njerës dhe tjetres. Parashtrohet pyetja cilat kishin me qen format më të shpeshta të blerjes së një biznesi?përgjigjësja kishte me qenë:

1. blerjen e drejt për drejt kur pronësia kalon nga një pronar ekzistues në një pronar të ri.
2. blerjen e një biznesi duke u bërë partner-duke e zavendësuar ndonjë aksionar të më parshem,
3. blerjen e një franshize ekzistuese duke i marr obligimet e blerësit të më parshëm të franshizës.
4. blerjen e një biznesi nga një menaxhment ekzistues -formë e privatizimit të shumë ndërmarrjeve- ku menaxherët dhe punëtorët kan bler ndermarrjet.

Gjithashtu para se të përcaktohet themeluesi apo themeluesit për biznes të ri përkatësisht, ai që orientohët për kyqjen në biznesin ekzistues duhët të analizohet mire puna e ndërmarrjes e sidomos këto arsye që kishin me qen më të rëndësishme apo kryesore:

1. Arsyet e shitjes,
 2. Profitabiliteti,
 3. Asetet (pasuria),
 4. Detyrimet,
 5. Aspektet juridike.
1. Tejkalmi i barrierave për hyrje në treg,
 2. kalimi i shpejt nga ideja në shitje,
 3. besimi me konsumatorët ekzistues,
 4. dija prezente në stafin ekzistues për teknologjin

Kurse të metat e blerjes së një biznesi ekzistues kishin me qenë:

1. vështirsia e përcaktimit të obligimeve dhe detyrimeve për shkak të pasiguris rreth evidencës kontabel,
2. rreziku nga asetet e paprekshme,
3. trashëgimia sidomos tek bizneset familjare,
4. Pavarsia më e vogël e ndërmarrësit në realizimin e ideve të veta pasi që jan të lidhura me biznesin ekzistues,
5. Stoque joadekuate dhe jokorrekte,

Si qendron puna me rastin e themelimit të një biznesi të ri përkatësisht para cilave dilemave gjindet themeluesi?

Per themelimin e një biznesi të ri esenciale është se duhët të bazohët në një plan të biznesit,që quhët elaborat-i cili paraqet nje arsyesheri. ¹⁵⁴

Pasi që të janë bërë të gjitha analizat mbi themelimin e një biznesi duhët të shiqohën anët pozitive dhe negative të krijimit të biznesit të ri.

Disa nga përparësit e themelimit të një biznesi të ri kishin me qenë:

1. Pronari ka mundësi vet ta zgjedh lokacionin e ndërmarrjes,
2. Pronari nuk i trashigon problemet që dalin si pasoj e trashëgimis negative të ndërmarrjes,

¹⁵² M.Mustafa,E.Kutllovci,P.Gashi,B.Krasniqi,“Biznesi I vogël dhe I mesëm,Prishtinë,2006,fq.45.

¹⁵³ M.Mustafa,E.Kutllovci,P.Gashi,B.Krasniqi,“Biznesi I vogël dhe I mesëm,Prishtinë,2006,fq.73.

¹⁵⁴ M.Mustafa,E.Kutllovci,P.Gashi,B.Krasniqi,“Biznesi I vogël dhe I mesëm,Prishtinë,2006,fq.45,73,74

3. Sipas afiniteteve dhe përparësive-pronari ka liri të plotë në organizimin e punës dhe udhëheqjen e saj,
4. E zgjedh vet personelin.

Disa nga të metat e themelimit të një biznesi të ri kishin me qenë:¹⁵⁵

1. Rreziku më i lart për falementimin në vitet e para të punës,
2. Vëllimi i madh i investimeve,
3. Vështirësi në krijimin e marrëdhënieve më të mira ndërmjet njerzëve brenda personelit,
4. Është e nevojshme koha për anulimin e problemeve fillestare që lidhën me sigurimin dhe vendosjen e rregullave,et

Formimi i Strukturave të ndërmarrjeve sipas sektorëve ekonomik në Republikën e Kosovës

Struktura ndërmarrjeve , sipas veprimtarive ekonomike,në Ministrin e Tregtis dhe Industris, është ndarë në 17 seksione (A - Q) sipas nomenklaturës së veprimtarive ekonomike:¹⁵⁶

- A) Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria,
- B) Peshkimi,
- C) Industria nxjerrëse (nxjerrja e qymyrit, linjiteve dhe shtresave të varfra të mineralit),
- E) Prodhimtaria, Furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë të ngrohtë,
- F) Ndërtimtaria,
- G) Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, si dhe artikujve për përdorimin personal dhe shtëpiak,
- H) Hotelet dhe restorantet,
- I) Transporti, magazinimi dhe komunikacioni,
- J) Ndërmjetësimi financiar,
- K) Afarizmi me pasuri të patundshme, dhënie me qira dhe shërbime të afarizmit,
- L) Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi social i detyrueshëm,
- M) Arsimi,
- N) Mbrojtja shëndetësore dhe sociale,
- O) Veprimtaritë e tjera shoqërore sociale të shërbimeve personale (pastrimi, evitimi i ujërave ndotës),
- P) Ekonomitë shtëpiake private me personel të punësuar,
- Q) Organizatat dhe trupat ndërkombëtare.

Regjistrimi i Bizneseve sipas llojit të bizneseve per vitin 2016¹⁵⁷

| Nr. | Lloji i biznesit | Nr. i bizneseve | Nr. i punëtorëve |
|-----|-------------------------------------|-----------------|------------------|
| 1 | Biznes individual | 6435 | 8333 |
| 2 | Kompani e huaj | 53 | 82 |
| 3 | Kooperativa Bujqësore | 5 | 25 |
| 4 | Ortakëria e përgjithshme | 39 | 76 |
| 5 | Shoqëri akcionare | 24 | 97 |
| 6 | Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara | 3992 | 9334 |
| | | 10548 | 17947 |

Parashtrohet pyetja cili kishte me qen kriteri kryesor i ndarjes së bizneseve sipas madhësis? përgjigjësja është se kriteri kryesor përkatësisht më i rëndësishëm është **numri i puntorve**.

Duke e marr parasysh kriterin kryesor, numrin e puntorve, shtetet e ndryshme ,në bazë të legjislacionit të tyre, kan bërë edhe kategorizimin e tyre në kategori dhe emertime të ndryshme.psh në Itali, Francë, Gjermani,etj ndryshon klasifikimi dhe emertimi pikerisht në bazë të numrit të puntorve.

Republika e Kosovës,si shtet i ri dhe me rregullim të ri ekonomik,ekonomia e tregut, legjislacionin e vet mbi ndërmarrjet kryesisht e ka bazuar në legjislacionin e Bashkimit Evropiane. Ministria e Tregtis dhe Industris, aty ku rexhistrohen bizneset, ku kriter ka marr për bazë numrin e puntorve, ka bërë këtë klasifikim të ndërmarrjeve:

¹⁵⁵ M.Mustafa,E.Kutllovci,P.Gashi,B.Krasniqi,“Biznesi I vogël dhe I mesëm,Prishtinë,2006,fq.75

¹⁵⁶ Shyqeri Kabashi, Revista Biznesi nr. 1, Prishtinë, 2007, fq.19

¹⁵⁷ Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë, Prishtinë, 31.12.2016.

Ndarja e bizneseve sipas numrit të të punësuarve në Republikën e Kosovës¹⁵⁸

Struktura bizneseve sipas madhësisë

| Klasifikimi | Numri i punëtorëve |
|--------------------|--------------------|
| Mikrondërmarrje | 1 - 9 punëtorë |
| Ndërmarrje e vogël | 10 - 49 punëtorë |
| Ndërmarrje e mesme | 50 - 249 punëtorë |
| Ndërmarrje e madhe | Mbi 250 punëtorë |

Struktura e ndërmarrjeve sipas statusit ligjor, numrit të ndërmarrjeve dhe përqindja e tyre për periudhën 31.12.2014 dhe

31.12.2016¹⁵⁹

| Nr. | Emerti i bizneseve | Nr i puntorve për llojin e biznesit | Nr. i bizneseve Deri me 31.12.2014 | Nr. i bizneseve Deri me 31.12.2016 | Nr i të punësuarve 31.12.2014 | Nr i të punësuarve 31.12.2014 | (%)e bizneseve 2014-2016 | (%) e punëtoreve 2014-2016 |
|-----|--------------------|-------------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|--------------------------|----------------------------|
| 1 | Mikrondërmarrje | 1-9 punëtorë | 131 631 | 152047 | 212412 | 242330 | 15,51 | 14,08 |
| 2 | Ndërmarrje e vogël | 10-49 punëtorë | 1534 | 1721 | 26063 | 28919 | 12,19 | 10,95 |
| 3 | Ndërmarrje mesme | 50-249 punëtorë | 244 | 257 | 24955 | 26188 | 5,32 | 4,95 |
| 4 | Ndërmarrje e madhe | Mbi 250 punëtorë | 43 | 45 | 50180 | 51150 | 4,65 | 1,93 |
| | Gjithsej | | 133 452 | 154070 | 313610 | 348587 | 15,45 | 11,15 |

KONKLUZIME

- Nga viti në vit kemi rritje të numrit të bizneseve, dhe atë në vitin 2014 kemi 9592 biznese përkatësisht 10848 në vitin 2016 apo 13,09% ma i madh se vitin 2014.

- Nga viti në vit kemi rritje të numrit të puntorve dhe atë në vitin 2014 kemi 16 530 punëtor përkatësisht 17947 në vitin 2016 apo 8,57% ma i madh se në vitin 2014.

-Numri i përgjithshëm i bizneseve nga 1990 e deri me 31.12.2016 është 154070-ky numer poqese krahasohet me numrin të cilin e jep Administrata Tatimore e Kosovës, që është diku rreth 35000 biznese të cilat janë aktive dhe paguajn tatim, del se vetëm 22,71% e bizneseve janë aktive. Bizneset tjera janë të regjistruara ,sigurisht, për qëllime të caktuar, që ta marrin ndonjë vize, ta shfrytzojnë disa muaj një biznes të tillë dhe ma von ta mbyllin apo për qëllime tjera të caktuara

- Numri i përgjithshëm i puntoreve nga 1990 e deri me 31.12.2016 është 348587 Poqese këto të dhëna i krahasojm me premtimet e qeveritareve tane në kohën e zgjedhjeve del se ky numer është thueja i barabart sa premtojn për një mandat).

Poqese i analizojm se cka kanë bërë qeveritë e Kosovës për bizneset mund të konstatojm se thueja asgjë-asgjë për faktin se bizneset e Kosovës nuk kanë pasur kurrfarë përkrashje për zhvillimin e tyre. Qeveritë e Kosovës bizneset jo që nuk i kanë ndihmuar por ato i kanë penguar dhe atë sidomos me ngarkimin me doganë për lenden e par, nuk i kanë liruar nga tatimet e të gjitha formave për një periudhë të caktuar gjashtë muaj apo vjetore, nuk i stimulojnë bizneset me rastin e punësimit të puntoreve të ri, nuk i mbron bizneset nga konkurrenca jolegale përkatësisht nga ekonomia informale e sidomos ekonominë informale që sjell veriu i vendit.

REZYME

Konkluzioni fillestar qëndron në atë se ,në punim,janë dhënë disa karakteristika të përgjithshme mbi bizneset e vogla,vazhdon lidhur format dhe menyrat e kyqjes së tyre në biznes dhe atë në bazë të veprimtarive,formës

¹⁵⁸ Shyqeri Kabashi, Revista Biznesi nr 1, Prishtinë, 2007.

¹⁵⁹ Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë, Prishtinë, 31.12.2014 dhe 31.12.2016

ligjore dhe madhësive të ndryshme. Punimi është i thurur në atë mënyrë që mund të konkludojmë se përbëhet prej dy pjesës kryesore. Në pjesën e parë bëhet fjalë lidhur me karakteristikat e përgjithshme të bizneseve të vogla dhe definicionet e dhëna nga disa autorë dhe institucione të ndryshme mbi bizneset e vogla-ku lidhet mbi rëndësinë.

Pjesa e dytë ka të bëjë lidhur mbi zhvillimin e bizneseve në përgjithësi e të voglave në veçanti. Fillon me fillimin e regjistrimeve të bizneseve para në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar (XX), fazat e zhvillimit të bizneseve në Kosovë dhe vazhdon me numrin e bizneseve prej vitit 1990 e deri më 31.12.2016.

Në punim në mënyrë shumë të qartë dhe të duhur janë shfrytëzuar të dhënat nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë mbi regjistrimet e bizneseve pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, ku përmes këtyre të dhënave kemi analizuar numrin e bizneseve të regjistruara në Kosovë si tërësi, numrin e të punësuarve nëpër këto lloje të bizneseve, llojin e bizneseve (ndarja e bizneseve sipas kriterit të të punësuarve), regjistrimin e bizneseve nëpër rajone dhe numrin e bizneseve nëpër komuna të Kosovës, në veçanti.

Gjatë analizës së të dhënave, përkatësisht përpunimit të të dhënave është konstatuar se numri më i madh i bizneseve në Kosovë është i regjistruar në kategorinë e bizneseve-mikrondërmarrje (1-9 punëtorë) që kanë numrin 131631 deri me 31.12. 2104 përkatësisht 152047 biznese deri me 31.12.2016(nga numri i përgjithshëm i bizneseve 133452 deri me 31.12.2014 përkatësisht 154070 deri me 31.12.2016) apo 98,63 % nga numri i përgjithshëm i bizneseve të regjistruara në Kosovë deri me 31.12.2014 përkatësisht 98,67% nga numri i përgjithshëm i bizneseve të regjistruara në Kosovë deri me 31.12.2016.

Gjithashtu, është konstatuar se numri më i madh i të punësuarve në Kosovë është i punësuar në llojin e bizneseve mikrondërmarrje e që arrin numrin 212412 deri me 31.12.2014 (ku numri i përgjithshëm i të punësuarve në Kosovë është 313610 deri me 31.12.2014) apo 67,73 % nga numri i përgjithshëm i të punësuarve deri me 31.12.2016.

LITERATURA

- [1] M.Mustafa,E.Kutllovci,P.Gashi,B.Krasniqi,“Biznesi I vogël dhe I mesëm, Prishtinë,2006,fq.45.
- [2] Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë, Prishtinë, 31.12.2016.
- [3] Shyqeri Kabashi, Revista Biznesi nr 1, Prishtinë, 2007.